



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_920_03_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 10.04.2013

në seancën e mbajtur më datë 28 qershor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE**t ankesa e konsumatorit Z.E., (shifra e konsumatorit: DGL - 38) nga Gjilani ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_920_03_13 i datës 26.03.2013.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës ka prezantuar kontratën e lidhur me datë 07.11.2008 nga palët kontraktuese Z. E. si pronarë i banesës dhe R.I. si pronarë i materialit ndërtimor e cila evidentohet në bazë të faturës nr. 01006. Palët kontraktuese janë pajtuar që pronari Z.E. t'i japë banesën e cila gjendet në Gjilan, Rr: "Kamnik II" AS-21/1 R.I. ndërsa ky i fundit në kompensim të mjeteve monetare t'i jap materialin ndërtimor në po të njëjtën vlerë pronarit të banesës Z. E.

Pas kësaj parashtruesi i ankesës ka prezantuar edhe një kontratë të lidhur me datë 09.12.2008 në mes R.I. në cilësinë e shitësit të banesës dhe T.P. në cilësinë e blerësit të banesës.

Nga shkresat e lëndës vërehet se me datë 22.10.2010 është lidhur prapë një kontratë për shitjen e banesës së theksuar më lartë në mes të palëve kontraktuese T.P. dhe G. D.

Gjithashtu parashtruesi i ankesës ka prezantuar edhe kontratën tjetër të kësaj banese e lidhur me datë 11.07.2011 në mes palëve kontraktuese G.D. dhe M.B., kjo kontratë shitblerje është e vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Gjilan.

Parashtruesi i ankesës ka prezantuar një deklaratë me shkrim të dhënë nga ish-Pronari kësaj banese, me të cilën deklaron se banesën për të cilën bëhet fjalë ka jetuar Z. E. me dy djemtë e tij F. dhe A. E. qysh nga ndarja e saj nga BVI-ja dhe se kanë jetuar deri me datën 24.04.2010 kur i ka shitur R. H. Në vazhdim të deklaratës theksohet se është me rëndësi të potencohet se për gjatë tërë kësaj periudhe ku është bërë shitja e banesës disa herë nga R. H. tek T. P., pastaj nga T. P. i është shitur G. D. dhe ky i fundit i ka shitur M. B., ka qëndruar në banesë Z.E. dhe e ka krijuar këtë borxh diku në vlerë prej 4.900€. Pas lëshimit të kësaj banese kemi identifikuar gjendjen e shpenzimit të kilovatëve në njehsor



së bashku me F. E., dhe gjendja e njehsorit ka qenë kjo Tarifa I -282096 dhe Tarifa II- 289313, andaj deklarojë se deri me datë e theksuar më lartë obligimet janë të pronarit të banesës Z. E.

Parashtruesi i ankesës ka siguruar deklaratën e dhënë me shkrim nga Z. E. me datë 15.09.2012 me të cilën ka theksuar se banesa në Kamnik II As-21/1 Nr 1 kati –I ka qenë pronë e imja prej kur më ka ndarë BVI-ja. Deklarata vazhdon duke theksuar se prej kur i a ka ndarë BVI-ja ka jetuar në banesë e deri kur ia ka shitur R.H. në vitin 2008, dhe më këtë kemi bërë marrëveshje që i njëjti t'ia ndërtoi dy shtëpi në rrugën e Malishevës dhe pastaj t'ia bëjë lirimin e banesës, ku edhe të njëjtën ia ka liruar me datë 24.04.2010. Gjendja e njehsorit elektrik në atë periudhë ka qenë: Tarifa I -282096 dhe Tarifa II- 289313, ashtu që deri me këtë datë i njëjti ka deklaruar që të gjitha shpenzimet komunale dhe energjinë elektrike do t'i bart si shpenzime të tij.

Parashtruesi i ankesës ka siguruar deklaratën e dhënë nga djali F. Z. E., me të cilën deklaron që obligimet e KEK-ut, për borxhin e krijuar të energjisë elektrike në vlerë prej 4800€ të mbetur në emër të babait tim Z. E. në shifër DGL-38, fatura me numër të njehsorit 4847729 në rrugën „Gjon Sereqi” e pranoi të bartet në emrin tim, kjo shumë prej 4800€ të bartet në numrin e njehsorit 9028545 që figuron në emër të F. E. në rrugën Kufcë e Poshtme Gjilan. I njëjti deklaron se këtë deklaratë e bëjmë në pajtim me babain e tij dhe të njëjtën e nënshkruajmë në Gjykatën Komunale në Gjilan.

Me datë 18.12.2012 konsumatori Z. E. ka bërë kërkesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kërkuar nga KEK-u, që të bëj bartjen e borxhit në shifrën e Z. E. ashtu sipas marrëveshjes së bërë në Gjykatën Komunale në Gjilan për pranim të borxhit.

Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur ankesës së konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se ky konsumator ka pasur edhe një herë një riprogramim të borxhit dhe nuk i është përmbajtur fare, andaj edhe i refuzohet një kërkesë e tillë për një riprogramim tjetër të borxhit pasi që nuk ka arsye

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 26.03.2013 ka nxjerr vendim duke e pranuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: *i)* të shkarkojë nga borxhi i energjisë elektrike shifrën e konsumatorit DGL-38, e që tani është duke e shfrytëzuar M. B. e i cili borxh është krijuar nga konsumatori Z. E. në vlerë prej 4,800€; *ii)* të bart vlerën e borxhit prej 4,800€ në shifrën e konsumatorit F. E. në shifër DGL-9028545, ashtu siç përcaktohet në deklaratën e tij të dhënë në Gjykatën Komunale në Gjilan me datë 12.12.2012

Pas marrjes se vendimit të DMK-së, më datë 10.04.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_920_03_13 të datës 26.03.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nuk pajtohet me vendimin e DMK-së pasi që asnjëherë nuk ka kërkuar që borxhi prej 4800€ nga shifra DGL – 38 t'i bartet në shifrën e tij DGL – 9028545. Konsumatori po ashtu thekson se parashtruesi i ankesës T. P. ka falsifikuar nënshkrimin e tij në gjykatë, si dhe ai banesën ia ka shitur R. H. dhe më të janë marrë vesh dhe jo me T. P.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me datë 28.06.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës DGL – 38 dhe ka vërejtur se nga periudha kohore 2002 deri më 04/2010 shihet se ka shpenzim të energjisë elektrike, nga periudha 05/2010 – 07/2011 kjo shifër kryesisht është faturuar vetëm me taksa, si dhe prej periudhës 08/2011 e deri më 02/2013 kjo shifër është faturuar propë me shpenzime. Bordi i ZRRE-së po ashtu gjatë analizës së lëndës së konsumatorit konstaton se KEK-u është dashur të bëjë inkasimin me rregull për energjinë e shpenzuar nga konsumatori gjatë periudhës kur ka bërë këtë shpenzim, e jo të obligohet dikush tjetër të bëjë pagesën e energjisë elektrike, pasi



që kjo bie në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi, përkatësisht me nenin 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku përshkruhen saktë parimet e përgjithshme të drejtat dhe obligimet lidhur me furnizimin me energji elektrike, e që në fakt të gjithë konsumatorët duhet të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë

Bordi i ZRRE-së po ashtu ka analizuar kontratat e paraqitura nga konsumatori, deklaratat e personave e të vërtetuara në gjykatë si dhe dëshmitë e paraqitura nga palët dhe gjatë analizës konstaton se në bazë të vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe deklaratat e personave që kanë bërë shpenzimin e energjisë elektrike, deklaratave të dëshmitarëve të cilët dëshmojnë se kush ka qenë duke banuar për këtë periudhë kohore si dhe duke i marr për bazë edhe kontratat e lidhura për shitblerjen e kësaj banese, vijmë në përfundim se KEK-u ka qenë e obliguar që mbi bazën e deklaratës së dhënë në Gjykatën Komunale në Gjilan me datë 12.12.2012 e të nënshkruar nga Z. dhe F. E. dhe të vërtetuar nga kjo gjykatë, me të cilën kërkojnë se borxh i në vlerë prej 4,800€ të bartet në numrin e njehsorit 9028545 që figuron në emër të F. E. në rrugën Kufcë e Poshtme Gjilan, pasi që të njëjtit edhe janë shpenzues të kësaj energjie elektrike është dashur t'iu bartet në këtë adresë dhe i njëjti borxh të kërkohej nga ta ashtu siç përcaktohet me rregullat në fuqi.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës Z. E., në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_920_02_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar